UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02/2686 Datë.18/11/2026

Bazuar në enin 23, pika 1.13 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka", Këshilli Drejtues në mbledhjen e njëzet e dytë (XXII) të mbajtur më datë 12.11.2026, mori vendim të shpall:

K O N K U R S

I. Kushtet e përgjithshme

Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e nivelit baçelor dhe master, të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të rregullt;
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lart;
3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
4. T'i kenë përfunduar të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e rregullt të shtatorit.

II. Kriteret shtesë

Studentët duhet t'i plotësojnë edhe kriteret shtesë të miratuara nga Senati, si në vijim:

1. Studentët e nivelit baçelor të Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, dhe Fakultetit të Shkencave Sociale duhet të kenë notën mesatare së paku 9.00;
2. Studentët e nivelit baçelor të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike duhet të kenë notën mesatare së paku 8.50;
3. Studentët e nivelit master 2 vjeçar duhet të kenë notën mesatare së paku 9.00.

III. Shuma e bursës

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 12.11.2026, ka përcaktuar shumën e përgjithshme buxhetore për ndarjen e bursave universitare, si dhe lartësinë e bursës për secilin student përfitues, në shumën prej **1,000.00** euro.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Studentët që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat I dhe II të këtij konkursi duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Formularin e plotësuar të aplikimit (i cili mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Universitetit);
2. Certifikatën e notave për nevoja të brendshme (e lëshuar pa pagesë nga Shërbimi i Studentëve);
3. Kopjen e letërnjoftimit;
4. Vërtetimin e llogarisë bankare.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

1. Aplikimi për bursë universitare bëhet nga data 19.11.2026 deri më 27.11.2026, deri në orën 15:00.
2. Dokumentet e kërkuara dorëzohen në zyrat e Shërbimit të Studentëve në fakultetin përkatës.